



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
(SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME, SHKODËR)

Nr. _____ prot.

Shkodër, më _____. _____. 2024

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës për informacion.

Për dijeni: Bashkia Shkodër

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion Bazuar ne Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" ju bëjmë me dije:

1. Furnizimi me ujë i qytetit të Shkodrës realizohet me ngritje mekanike nga uji i pompuar nga stacionet e pompimit Dobraç dhe Bahçallëk. Njesite administrative furnizohen me uje nga 18 stacionet e pompimit, ku përveç stacionit te Thethit dhe Dragoçit, të cilat janë ndërtime të reja, të gjitha stacionet e tjera janë shumë të amortizuara. Furnizimi me ujë i qytetit ka qënë normal dhe pjesa më e madhe e qytetit ka furnizim me ujë 24 orë pa ndërprerje. Nga ana tjetër janë bërë përpjekje maksimale për përmirësimin e furnizimit me ujë të zonave rurale, duke vendosur rregjim të paracaktuar të ndezjes së pompave dhe të furnizimit me ujë të banorëve të këtyre zonave. Problemet e shumta teknike dhe niveli i larte i amortizimit të agregateve prodhues të këtyre zonave, kushtëzon orët e reduktuara të furnizimit me ujë në disa orë gjatë ditës. Përjashtim bën ujësjellësi i Thethit dhe Dragoç, të cilët arrijnë të furnizojnë banorët e atyre zonave 24 orë pa ndërprerje.

Zonat që janë nën juridiksionin e Bashkisë Shkodër furnizohen mesatarisht 22.21 orë në ditë me ujë të pijshëm. Zonat urbane furnizohen 22.75 orë, ndërsa zonat rurale mesatarisht 19.15 orë në ditë. Qyteti i Shkodrës është i organizuar në 27 zona të shërbimi, orët e furnizimit me ujë të secilës zonë janë te pasqyruara në tabelën mëposhtë:

Tabela Nr. 1 Orët e furnizimit me ujë te pijshëm.

Numri i idhjeve sipas zonave te faturimit	Numri i lidhjeve te ujit	Oret e Furnizimit
1	1862	24
2	1472	22
3	1282	24
4	1563	24
5	2656	24
6	1775	22
7	628	24
8	1759	24
9	1478	19
10	1624	24
11	1645	22
12	1256	24
13	1552	22
14	1404	22
15	1770	20
16	1698	22
17	1497	24
18	12	22
19	4	22
20	9	23
Nentotali deri te 20	26946	22.75
21	4	22
22	6	21
23	78	21
24	31	22
25	809	24
26	29	24
27	0	24
S	176	24
Numri I klienteve sipas njesive Admin.		
Ana Malit	448	12
Berdice	426	16
Dajc Shkoder	134	8
Guri Zi	137	8
Postribe	1372	19
Shale	77	24
Rrethina	510	12
Velipoje	2276	24
Nentotali dyte	6513	19.15
TOTALI	33459	22.21

Zonat rurale është e ndarë sipas njesive administrative përkatëse. Siç mund ta shohim me përjashtim të zonave turistike Velipojë dhe Theth, pjesa tjetër e njesive administrative janë me orar të kufizuar të furnizimit me ujë. Shkak është rrjeti i amortizuar dhe mungesa e investimeve.

2. Pavarësisht se zona e shërbimit është rritur ndjeshëm, problem i madh është mbulimi me shërbim, sidomos për zonat rurale, ku niveli aktual i mbulimit është 24%, ndërsa niveli i përgjithshëm i mbulimit me shërbimin e ujësjellesi vlerësohet të jetë rreth 59%, mbulimi me shërbimin e kanalizimeve është akoma më i ulët dhe vlerësohet se 47% e popullsisë së zonës së re të shërbimit i mundësohet shërbimi i largimit të ujërave të ndotura.

Tabela Nr. 2 Mbulueshmëria me shërbim

	Numri i banorëve që marrin shërbim	% e mbulueshmërisë
Popullsia që shërbehet nga sistemi I furnizimit me ujë- ne Qytet	101143	88%
Popullsia që shërbehet nga sistemi I furnizimit me ujë- ne Fshat	22041	24%
Popullsia totale që shërbehet nga sistemi i furnizimit me ujë	123184	59%
Popullsia me lidhje ne sistemin e kanalizimeve - ne Qytet	93235	81%
Popullsia me lidhje ne sistemin e kanalizimeve - ne Fshat	5199	6%
Popullsia totale me lidhje ne sistemin e kanalizimeve	98434	47%

Sfidë kryesore për SHRUKSH mbetet mbulimi me rrjet shpërndarjeje i zonave informale të qytetit, kjo kërkon investime kapitale. Në vitin 2024 pritet të fillojnë investimet me financim të KFW, ku vëmendje e veçantë nga stafi i SHRUKSH është kushtuar orientimit të investimeve në këto zona, për të bërë të mundur zvogëlimin e humbjeve, si rrjedhojë e eliminimit të ndërhyrjeve në tubat kryesore të transmetimit të ujit të pijshëm. Zonat e ashtëquajtura të bardha, ose pa shërbim janë sfida dhe shqetësimi kryesor për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër, pasi këto zona nuk kanë aspak shërbim të furnizimit me ujë të popullatës së tyre. Problem tjetër madhor është edhe shkalla e lartë e amortizimit të tyre, kjo bën që edhe defektet e çarjeve të tubave të jenë të shpeshta dhe kostot e riparimeve të larta.

3. Niveli i arkëtimit për Ujësjellës Kanalizime Shkodër nga viti 2013-2023 paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr. 3 Arkëtimet në (000) lekë 2013-2023

Viti	Arkëtimet në (000) lekë
2013	148,195.8
2014	181,843.9
2015	212,310.01
2016	221,794.3
2017	223,651.7
2018	312,748.2

2019	294,458.9
2020	313,616.1
2021	270,680.1
2022	263,070.9
2023	255,851.9

Në vitin 2023 u bë rajonalizimi i Shoqërive të Ujësjetllës-Kanalizime dhe si rrjedhojë Ujësjetllës Kanalizime Shkodër iu bashkua edhe njesia e Vaut te Dejës, Pukës, Fushë Arrëzitet dhe Malësisë së Madhe. Numri total i punonjësve i Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër është 456 punonjës.